



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

Departamenti Statistikave Sociale një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar i/e statistikave të TIK në ekonomitë familjare

Numri i referencës : ASK-DSS-002

Koeficienti : 7

Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Bën planifikimin e aktiviteteve për anketën TIK;
2. Bën azhurnimin e pyetësorit të TIK si dhe udhëzuesit sipas metodologjisë së Eurostat-it, si dhe mban trajnimin për anketuesit;
3. Bën monitorimin/verifikimin e të dhënave të grumbulluara të Anketës TIK si dhe jep udhëzime për mbikëqyrësit dhe anketuesit;
4. Kontribuon në ngritjen e cilësisë së të dhënave të TIK;
5. Bën përgatitjen e micro të dhënave të TIK, për transmetim në Eurostat;
6. Përgatitë rezultatet e anketës TIK si dhe angazhohet në projektet që zhvillohen në njësinë e statistikave të standardit jetësor;
7. Merr pjesë në takime dhe Konferenca brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga ASK-ja apo nga donatorët në fushën e statistikave të përdorimit të TIK në ekonomitë familjare;
8. Kryen edhe punë tjera me kërkesë të eprorit;

-Kualifikimi : Diplomë universitare nga Fakulteti Ekonomik apo te ngjashme ;

-Përvoja e punës: Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale .

-Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohuri në kalkulimet statistikore (pastrimin e të dhënave, inputimin, validim dhe analiza);
- Njohuri profesionale mbi treguesit e TIK;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike;
- Shkathtësi në komunikim;

- Azbur dhe i/e gatshëm në kryerjen e detyrave të punës;
- Shkathtësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point , njohuri të theksuara të programit për analiza statistikore SPSS, STATA);
- Njohja e gjuhës angleze.

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës , Rr,”Zenel Salihu” nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës profesionale , vertetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyren e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.